



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 07-104/ 02-31243/25
Kaçanik, 30.12.2025

Në mbështetje të nenit 12. 2 (d), 17 (f) dhe (p) të Ligjit Nr. 03 L-040 për Vetëqeverisje lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 53 pika 3 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/21 Qershor 2016), të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, të Kërkesës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës 6986-2/25 të datës 07.10.2025 dhe të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal 020-5524/4 prej datës 07.10.2025, duke vendosur sipas Kërkesës së DSHPE 07Nr. 104/02-31243/25 prej datës 22.12.2025, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 dhjetor 2025, merr këtë:

VENDIM

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT 01 NR.104/02-22117/25 TË DATËS 11.09.2025 PËR MIRATIMIN E PLANIT NDËRKOMUNAL PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETURINAVE NË RAJONIN E GJILANIT DHE FERIZAJT

1. Me këtë Vendim, SHFUQIZOHET Vendimi i Kuvendit të Komunës 01 NR.104/02-22117/25 i datës 11.09.2025 - për miratimin e Planit ndër komunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, për shkak të disa konstatimeve të organit shqyrtues, MMPHI, MAPL, të vërtetuara edhe nga DSHPE, si vijon:
1.1 Plani nuk është në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, gjë që është konstatuar nga organi mbikëqyrës kompetent, MMPHI dhe MAPL.
1.2 Plani ndërkomunal duhet të plotësohet dhe ndryshohet konform kërkesave dhe rekomandimeve.
1.3 Vendimi është i pazbatueshëm në formën aktuale dhe mbajtja në fuqi e këtij vendimi, cenon parimin e ligjshmërisë dhe sigurinë juridike.
2. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do përkujdeset Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave (përmes kësaj drejtorie njoftohen mekanizmat tjerë relevantë); Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Seladin Troni



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 104/02-22117/25
Kaçanik, 11.09.2025

Në bazë të nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale, Komunës, Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-071 dhe Ligji Nr. 04/L-010 për Bashkëpunimin Ndërkomunal, të nenit 6.2 lidhur me nenin 35 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit 01Nr. 104/02-22117/25 të Kryetarit të Komunës, të arsyetuar nga drejtoria e Shërbimeve publike dhe Emergjencave, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 11 shtator 2025, mori këtë:

VENDIM

Për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt

1. Me këtë Vendim, MIRATOHET Plani Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave dhe Inspektorati komunal.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:
 - Plani Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt;
 - Dokumenti i vlerësimit të ndikimit në mjedis Iniciativa për bashkëpunim ndërmjet komunave përkatëse në fushën e sektorit të menaxhimit të integruar të mbeturinave;
 - Vendimi 01Nr. 07-104/01-7011/23 për miratimin e Iniciativës për bashkëpunim ndër komunal ndërmjet komunave të regjionit të Gjilanit dhe Ferizajt në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave;
 - Vendimi për Pëlqim mjedisor për raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM), për Komunitat e rajonit të Gjilanit dhe Ferizajt nga MMPHI nr. 5496-2/25 i datës 20.08.2025.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë (përmes saj njoftohen organet tjera relevante), Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLICA KOSOVA / РЕПУБЛИКА КООСОВЕ	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. jedinica Org. Unit	AL
Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	-02-
Nr. i Prot. Br. Prot. Prot. No.	37-2/20
Data Datum Date	21.01.2026
PRISHTINE / A	
No. 1	

Data	23.01.26	Vendi	KAÇANIK
Ij. org.		Numri	01 105/02-2076
		Shtojcë	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Për:	Sabedin Vishi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në Detyrë në MAPL Jeton Qela Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Hysen Durmishi, U.D Ministër në Detyrë në MMPHI Izedin Bytyqi, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	
1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	i Arta Krasniqi – Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Bashkëpunim Ndërinstitucional në Fushën e
2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	i Përfaqësimeve Gjyqësore dhe Koordinim të Marrëveshjeve
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal
Lloji i aktit:	Vendimi 01/Nr.07-104/02-31243/25 për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.104/02-22117/25 të datës 11.09.2025 për miratimin e planit ndër komunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave në rajonin e Gjilanit dhe Ferizajit

I nderuar kryetar Vishi,
I nderuar kryesues Troni,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 08.01.2026 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Vendimin 01/Nr.07-104/02-31243/25 për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.104/02-22117/25 të datës 11.09.2025 për miratimin e planit ndër komunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave në rajonin e Gjilanit dhe Ferizajit:

KONFIRMON

Vendimin 01/Nr.07-104/02-31243/25 për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.104/02-22117/25 të datës 11.09.2025 për miratimin e planit ndër komunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave në rajonin e Gjilanit dhe Ferizajit

ARSYETIMI

MMPHI pas shqyrtimit të vendimit të lartcekur konstatoi se:

Kuvendi Komunal i Kaçanikut ka vepruar në përputhje me vlerësimin e ligjshmërisë Nr. Prot. 6986-2/25, datë 07.10.2025 të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Në përputhje me këto vlerësime është shfuqizuar Vendimi 01 Nr.104/02-22117/25 i datës 11.09.2025 për miratimin e planit ndër komunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave në rajonin e Gjilanit dhe Ferizajit

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës mbetet në dispozicion të Komunës së Kaçanikut dhe MAPL-së për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

